



INSTITUTI "HARRY FULTZ"
Shkollë e Mesme & Kolegji Komunitar
Tradita e Ekselencës



**Junior
Achievement
of Albania**

Anëtar i
JA Worldwide



Shtojz-eco

**Kompania studentore Shtojz-eco
Institutit "Harry Fultz"
Tiranë-Shqipëri**

PËRMBAJTJA

01



- **Përmbledhja ekzekutive ----- 02**
- **Bordi Drejtues ----- 03**
- **Tregu ----- 04**
- **Produkti ----- 05**
- **Marketingu ----- 06**
- **Analiza financiare ----- 07-08**
- **Përmbledhje e raportit ----- 09**
- **Fjala e CEO-s për aksionerët ----- 10**
- **Fjala e CEO-s për Vullnetarët ----- 11**
- **Statuti i Shoqërisë ----- 12**



Ne, një grup nxënësish të shkollës “Harry Fultz”, kemi zgjedhur të angazhohemi në programin “Junior Achievement” direkt pasi na u ofrua si mundësi në programin mësimor. Dëshira për të marrë pjesë në këtë program na nxiti që të mendojmë dhe të evidentojmë disa probleme prezente në Shqipëri dhe ne si ekip nxënësish do të mund të jepnim kontributin tonë në gjetjen e zgjidhjeve konkrete për këto problematika aktuale. Nga kjo nxitje lindi kompania studentore “Shtojz-eco”.

Gjatë shpalosjes së ideve dominoi shqetësimi që lidhet me ujërat e ndotur nga hidrokarburet dhe derivatet e tyre ku për këtë shqetësim u përdor një studim i kryer nga [ReaserchGate](#). Nga ku zbuluam që hidrokarburet kanë tendencën të përthithen nga gëzofi i shumë gjitarve detar si arinj polar, foka, luanë deti dhe vidrat. Zgjidhja që propozuam ishte krijimi i sfungjerve nga mbetje urbane (flokë njerëzor) të siguruar nga sallonet e parukierisë dhe berberhaneve. Kjo iniciativë lindi nga shqetësimi i përditshëm për ndotjen dhe nevojën për të kaluar nga vëzhgimi tek veprimi real.

Grupi jonë beson se zgjidhjet më të qëndrueshme fillojnë nga individët e rinj dhe nga veprimet e vogla që kanë ndikim të madh në komunitet. Për këtë arsye, ne jemi të motivuar nga ideja se “ne nuk presim ndryshimin — ne e nisim atë.” Kjo qasje na ka shtyrë të mendojmë për projekte konkrete që kontribuojnë në mbrojtjen e mjedisit dhe përmirësimin e jetës urbane, me një dëshirë të madhe për tu bërë një shembull jo vetëm mes të rinjve por mes çdokujt që ka ide të veçanta dhe të guximshme.

Fitimi është planifikuar të arrihet me anë të shitjes së produkteve tona me modelin B2B institucioneve, ndërmarrjeve dhe bizneseve private që merren me nxjerrjen, prodhimin, perpunimin ose konsumin në sasi të vogla ose të mëdha të hidrokarbureve dhe derivatet e saj.

“Shtojz-eco” është një kompani e cila nuk mbetet thjesht në kuadrin e një ideje apo e një kompanie që prodhon vetëm kosto, por e një kompanie që përmes aktivitetit të saj gjeneron dhe të ardhura. E veçanta e kompanisë tonë ndryshe nga shumë kompani dhe industri të tjera të cilat me rritjen e aktivitetit rritet dhe ndotja e mjedisit ose kostove të ndërmarrjes për ta mbrojtur atë, kompania jonë sa më shumë rritet aq më shumë e mbron mjedisin njëkohësisht duke gjeneruar të ardhura që përkthehet në fitim.

BORDI DREJTUES

03



Anagreis Adëraj
PR

Klea Quku
Shef i Dep. Financës

Ardi Kapllani
CEO

Enea Prifti
Shef i Dep. Prodhimit



Julia Nini
Shefe e Dep.
Marketing



Ndotja nga hidrokarburet dhe derivatet e tyre është një problem jo vetëm në ekosistem por edhe në industri të ndryshme duke shkaktuar probleme që rrisin kostot e operimit ose kërkojnë një kosto të lartë pastrimi. Deri më tani veprimi që ndërmerrej nga këto industri ose autoritete ka qënë vetëm spostim ose neglizhim i problemit pa i dhënë një zgjidhje konkrete, ndërsa ne ofrojmë një zgjidhje më efikase me sfungjerët tanë me matreial 100% të ricikluar dhe biodegradueshëm. Si rrjedhojë aplikimi dhe trajtimi pas përdorimit i sfungjerve tanë është mjaft i lehtë.

Aktualisht, tregu i filtrave për thithjen e hidrokarbureve dhe vajrave dominohet nga produkte sintetike industriale, si materiale plastike dhe fibra artificiale, të cilat përdoren gjerësisht në servise, industri dhe ndërhyrje mjedisore. Edhe pse janë funksionale, këto produkte kanë kosto më të lartë dhe shpesh shkaktojnë ndikim negativ në mjedis pas përdorimit.

Filtrat me bazë flokët njerëzorë përbëjnë një alternativë inovative dhe ekologjike, pasi përdorin një material natyror, të riciklueshëm dhe lehtësisht të disponueshëm. Ata ofrojnë kosto më të ulët prodhimi, ndikim pozitiv në mjedis dhe mundësi për t'u integruar në ekonominë qarkulluese përmes bashkëpunimit me komunitetin dhe bizneset lokale. Në nivel lokal, konkurrenca është e kufizuar, pasi kjo praktikë nuk është ende e përhapur, duke krijuar një mundësi të mirë për zhvillim dhe zgjerim të projektit në bashkëpunim me institucione publike dhe ato private.

Flokët njerëzorë kanë strukturë keratine me aftësi shumë të lartë absorbimi të hidrokarbureve. Aplikimet praktike përfshijnë:

- jastëkë absorbues për vajra
- barriera lundruese për ujëra
- filtra për kanale kullimi
- filtra për autolarje
- filtra për industri ushqimore
- sisteme parapastrimi për impiante trajtimi

Ndotja nga vajrat dhe hidrokarburet ndodh shpesh në:

- autolarje
- servise automjetesh
- pika karburanti
- industri mekanike
- porte dhe marina
- kuzhina industriale
- aktivitete ndërtimi
- rrjedhje aksidentale urbane

Elementi	Shtojz-eco	3M	New Pig
Absorbim vajrash			
Biodegradueshmëri			
Kosto e ulët			
Material i riciklueshëm			
Ndikim i ulët mjedisor			
Lehtësi përdorimi			
Inovacion			
Disponueshmëri lokale			

PRODUKTI

05

Sfungjerët tanë prodhohen plotësisht me dorë nga vetë ne si studentë, duke u përfshirë në çdo fazë të procesit, nga ideimi deri te produkti përfundimtar. Ekipi i punës, i koordinuar nga shefi i departamentit Enea Prifti, është i ndarë në disa nënsektorë funksionalë që merren me mbledhjen e materialeve, përpunimin dhe ambalazhimin. Kjo strukturë na ka ndihmuar të organizojmë më mirë punën dhe të arrijmë një produkt cilësor përmes bashkëpunimit dhe ndarjes së përgjegjësisë. Gjithashtu, gjatë procesit kemi eksperimentuar me disa variante derisa kemi arritur modelin aktual, duke përmirësuar vazhdimisht funksionalitetin dhe qëndrueshmërinë e sfungjerit.

Për sigurimin e lëndës së parë, kemi bashkëpunuar me sallone estetike dhe berberhane në komunitet, të cilat na kanë furnizuar falas me mbetje urbane (flokë). Si vend grumbullimi dhe përpunimi kemi përdorur garazhin e njërit prej studentëve, me lejen e prindërve të tij, çka na ka mundësuar të shmangim kostot e qirasë. Coha e përdorur për mbështjellësen është marrë në pika shumice si materiale “scarto” të destinuara për t’u hedhur, duke ulur më tej kostot dhe duke rritur aspektin ekologjik të produktit. Kostot kryesore kanë qenë minimale dhe lidhen kryesisht me materialet ndihmëse dhe printimin e logos për ambalazhim. Produkti përfundimtar përbëhet nga një mbështjellëse elastike prej cohe të ricikluar, brenda së cilës vendoset lënda e parë e përpunuar si material absorbues. Në fazën e fundit, sfungjerët paktohen me kujdes, ku çdo pako përmban dy njësi, duke e bërë produktin praktik për përdorim dhe të gatshëm për treg.



MARKETINGU

06

Për të testuar pranueshmërinë e idesë dhe për të rritur ndërgjegjësimin mjedisor, projekti u promovua përmes kanaleve digjitale si Instagram me video informuese. Qasja e përdorur ishte e thjeshtë, vizuale dhe e fokusuar në shpjegimin e problemit dhe zgjidhjes së propozuar.

Publikimi i përmbajtjeve ka gjeneruar interes dhe reagime pozitive, veçanërisht tek të rinjtë, duke treguar se temat e inovacionit mjedisor dhe riciklimit kanë potencial të lartë angazhimi. Videot kanë ndihmuar në thjeshtimin e konceptit dhe në rritjen e kuptueshmërisë së idesë teknike.

Ky proces shërbeu edhe si një formë vlerësimi i hershëm i idesë, duke treguar se ajo është e kuptueshme, e pranueshme dhe e komunikueshme me publikun. Në këtë mënyrë, marketingu nuk u përdor vetëm për promovim, por edhe për të vlerësuar interesin real ndaj zgjidhjes së propozuar.


Aktiviteti në Instagram

Në shikueshmëri e reklamës tonë




Ditët e tjera
200

Dita 2
450



Dita 1
1000

Professional dashboard	
Insights	13 Mar-11 Apr
Views	5.0K
Interactions	293
New followers	0
Content you shared	16



ANALIZA FINANCIARE

07



Analiza paraprake tregon se kostoja e prodhimit për një njësi të filtrit ekologjik me flokë njerëzor vlerësohet rreth 115 lekë, falë përdorimit të një lënde të parë lokale dhe me kosto minimale. Bazuar në krahasimin me produktet ekzistuese në treg, çmimi i parashikuar i shitjes është rreth 250 lekë për njësi. Kjo krijon një fitim bruto mesatar prej rreth 135 lekë për njësi. Marzhi i fitimit mbi 58% konsiderohet pozitiv për një produkt inovativ me bazë ekonominë qarkulluese. Struktura e ulët e koston dhe disponueshmëria lokale e materialit rrisin qëndrueshmërinë ekonomike të projektit. Kjo e bën zgjidhjen të shkallëzueshme, të përballueshme dhe me potencial real tregu për përdorim komunitar dhe industrial.

Analiza e koston për njësi (në lekë)

Elementi	Monedha	Kosto për njësi (lekë)
Lënda e parë (flokë)	Lekë	0
Pastrim dhe përpunim	Lekë	10
Material mbështetës (rrjetë/paketim)	Lekë	70
Punë manuale / prodhim	Lekë	30
Transport lokal	Lekë	5
Kosto totale për njësi	Lekë	115

Segmenti i tregut	Monedha	Çmimi i rekomanduar
Çmimi i sugjeruar per çmim pakice:	Lekë	250
Çmimi i sugjeruar per çmim shumice (100+ njësi)	Lekë	220

Marzhi I lidhur me çmim pakice	Monedha	Përlllogaritjet
kosto mesatare	Lekë	115
çmimi mesatar	Lekë	250
Fitimi bruto	Lekë	135
Marzhi i fitimit		54%

Marzhi I lidhur me çmim shumice	Monedha	Përlllogaritjet
kosto mesatare	Lekë	115
çmimi mesatar	Lekë	220
Fitimi bruto	Lekë	105
Marzhi i fitimit		42%



Aksionerët kanë vendosur që mos të tërheqin fitimin por ta riinvestojnë atë. Për të arritur pikën e break-even-point kompania duhet të shesë 12 njësi me çmimin e vendosur 250all për të shlyer vlerën fillestare të investimit. Me vlerën e investimit fillestar sipas kapitalit të aksionerëve (3000all), shoqëria arriti të prodhojë 26 njësi produkt. Kompania arriti të shesë 26 njësi. Deri në njësinë 12 shoqëria arriti të mbulojë kostot dhe nga njësia 13 deri në njësinë 26, shoqëria arriti të sigurojë fitim.

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	Periudha	Periudha
	Raportuese	Paraardhese
AKTIVET		
Aktive afatshkurtra		
<i>Mjete monetare</i>	6500	-
<i>Të drejta të arkëtueshme dhe të tiera investime financiare</i>	-	-
<i>Inventare</i>	-	-
Aktive afatgjata	-	-
TOTALI AKTIVEVE	6500	-
DETYRIMET DHE KAPITALI		
<i>Detyrimet</i>		
<i>Detyrime afatshkurtra</i>	-	-
<i>Detyrime afatgjata</i>	-	-
Shuma e detyrimeve	-	-
<i>Kapitali</i>		
Kapitali i nënshkruar	3000	-
Fitime/(Humbje) të periudhës financiare	3500	-
Fitime/(Humbje) të mbartura	0	-
Shuma e Kapitalit	6500	-
TOTALI DETYRIMET DHE KAPITALI	6500	-

Pasqyra e lëvizjeve në kapitalin neto	Kapitali i nënshkruar	Fitim/(humbja) e periudhës	Totali
Pozicioni financiar në fillim 2025	-	-	-
Pozicioni financiar i rideklaruar ne fillim	-	-	-
Fitim/(humbja) e periudhës			-
Dividende të shpërndarë			-
Totali i transaksioneve për pronarët e njësisë ekonomike	-	-	-
Pozicioni financiar në fund (viti paraardhës) 2025	-	-	-
Të ardhurat totale gjithëpërfshirëse të periudhës:			-
Fitim/(humbja) e periudhës		3500	3500
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse			-
Tatime aktuale dhe të shtyra të njohura drejtpërdrejt në kapital			-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për periudhën	-	3500	3500
Transaksione për pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:			-
Emetim i kapitalit të nënshkruar	3000		3000
Dividende të shpërndarë			-
Totali i transaksioneve për pronarët e njësisë ekonomike	3000	-	3000
Pozicioni financiar në fund (viti aktual)	3000	3500	6500

Emërtimi dhe Forma ligjore	Shtojz-Eco	
NIPT -i	A12345678E	
Adresa e Selisë	Gjimnazi "Harry Fultz"	
Data e krijimit	15.022.026	
Veprimtaria Kryesore	Prodhim materiale ekologjike për pastrimin e ujërave të ndotura	
	MIKRONJËSI	
(Në zbatim të Standartit Kombëtar të Kontabilitetit Nr.15 dhe Ligjit Nr. 9228 Datë 29.04.2004 Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare)		
	Viti 2026	
Pasqyra Financiare janë të shprehura në		LEK
Periudha Kontabël e Pasqyrave Financiare	Nga	15.022.026
	Deri	13.042.026
Data e mbylljes së Pasqyrave Financiare		13.042.026

PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE	Periudha
	Raportuese
Shitjet neto	6500
Mallrat, lëndët e para dhe shërbimet	(3,000)
Shpenzime të personelit	-
Shpenzime të tjera	-
Fitimi/(humbja) nga veprimtaritë e shfrytëzimit	3500
<i>Të ardhura e shpenzime financiare</i>	-
Shuma	-
Fitimi/(humbja) para tatimit	3500
Shpenzimet e tatimit mbi fitimin	-
Fitimi/(humbja) neto e periudhës financiare	3500

Ky projekt paraqet një qasje inovative ndaj menaxhimit të ndotjes së ujërave nga hidrokarburet, përmes zhvillimit të një materiali absorbues ekologjik të bazuar në flokë njerëzorë si burim i ricikluar biologjikisht i vlefshëm. Nisma mbështetet në parimet e ekonomisë qarkulluese, reduktimit të mbetjeve dhe përdorimit të burimeve lokale, në përputhje me objektivat e politikave mjedisore dhe të qëndrueshmërisë.

Analiza e studimit tregon se modeli i propozuar mund të realizohet me një strukturë të ulët kostoje dhe me potencial të lartë riprodhueshmërie në nivel lokal dhe komunitar. Krahasimi me teknologjitë ekzistuese tregon një avantazh në drejtim të ndikimit mjedisor dhe aksesit në lëndë të parë, ndërsa ruan konkurrueshmëri të arsyeshme në performancën funksionale.

Në aspektin social, projekti kontribuon në rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe në forcimin e bashkëpunimit komunitar përmes përfshirjes së vullnetarëve dhe aktiviteteve të komunikimit publik. Ky dimension e pozicionon iniciativën jo vetëm si një produkt teknologjik, por edhe si një instrument edukimi dhe angazhimi qytetar.

Në përfundim, projekti përfaqëson një model pilot të integruar që ndërthur inovacionin mjedisor, eficiencën ekonomike dhe impaktin social, duke ofruar potencial për zhvillim të mëtejshëm në kuadër të strategjive të qëndrueshme të menaxhimit të mbetjeve dhe mbrojtjes së mjedisit në nivel lokal dhe rajonal.



Të nderuar aksionerë,

Kam kënaqësinë t'ju informoj mbi zhvillimin e projektit tonë inovativ për prodhimin e filtrave ekologjike me bazë flokët njerëzore, një iniciativë që përfaqëson një hap konkret drejt integritit të ekonomisë qarkulluese, eficiencës së kostos dhe përgjegjësisë mjedisore në modelin tonë të zhvillimit.

Analizat paraprake tregojnë se projekti mbështetet në një strukturë prodhimi me kosto të ulët për njësi dhe marzh fitimi konkurrues, falë përdorimit të një lënde të parë lokale dhe të disponueshme. Interesi i tregut dhe reagimet pozitive nga komunikimi publik në rrjetet sociale kanë konfirmuar potencialin real për zhvillim dhe shkallëzim të kësaj zgjidhjeje.

Ky projekt krijon mundësi të qarta për diversifikim aktiviteti, rritje të vlerës së investimit dhe pozicionim strategjik në segmentin e produkteve ekologjike, një treg në rritje të vazhdueshme në nivel rajonal dhe ndërkombëtar.

Angazhimi ynë në fazën në vijim do të fokusohet në pilotimin e zgjeruar, forcimin e partneriteteve dhe konsolidimin e modelit të prodhimit, me synim kthimin e kësaj nisme në një linjë të qëndrueshme zhvillimi për kompaninë.

Ju falënderoj për besimin dhe mbështetjen tuaj të vazhdueshme në realizimin e projekteve me ndikim ekonomik dhe mjedisor afatgjatë.

Me respekt,

Ardi Kapllani, CEO i Shtojz-eco.

Të dashur vullnetarë,

Ju falënderoj sinqerisht për përkushtimin dhe energjinë që keni sjellë në këtë projekt. Angazhimi juaj ka qenë një faktor kyç në zhvillimin dhe promovimin e një ideje që synon të shndërrojë një mbetje të zakonshme urbane në një zgjidhje konkrete për mbrojtjen e mjedisit.

Kontributi juaj në mbledhjen e materialeve, në ndërgjegjësimin e komunitetit dhe në përhapjen e informacionit përmes aktiviteteve dhe rrjeteve sociale ka ndihmuar drejtpërdrejt në rritjen e dukshmërisë dhe besueshmërisë së projektit. Falë jush, kjo iniciativë nuk është vetëm një ide inovative, por një përpjekje e përbashkët me ndikim real në komunitet.

Ne besojmë se projekte të tilla ndërtohen mbi bashkëpunimin dhe vullnetin për të kontribuar në të mirën e përbashkët. Prania dhe mbështetja juaj janë një dëshmi e qartë se ndryshimi i qëndrueshëm fillon nga angazhimi qytetar.

Ju falënderoj për besimin dhe për rolin tuaj të çmuar në këtë rrugëtim të përbashkët drejt një mjedisi më të pastër dhe një shoqërie më të përgjegjshme.

Me respekt,

Ardi Kapllani, CEO i Shtojz-eco.

Shoqëria “SHTOJZ-ECO” Shpk është themeluar më 15 Shkurt 2026 në Tiranë nga një grup nxënësish të gjimnazit “Harry Fultz”, si një iniciativë edukative, inovative dhe mjedisore. Ajo funksionon në kuadër të projekteve shkollore dhe konkurseve shkencore.

Të dhëna kryesore

- Forma ligjore: Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (Shpk)
- Selia: Gjimnazi “Harry Fultz”, Tiranë
- Kohëzgjatja: E pacaktuar (derisa vazhdon aktiviteti)

Objekti i veprimtarisë

- Projektimin dhe prodhimin e pajisjeve për pastrimin e ujërave të ndotura nga vaji, duke përdorur flokët si material natyror absorbues
- Mbrojtjen e mjedisit dhe ndërgjegjësimin ekologjik
- Zhvillimin e inovacionit tek të rinjtë dhe projekteve të qëndrueshme

Kapitali dhe ortakët

- Kapitali fillestar: 3,000 lekë
- I ndarë në mënyrë të barabartë mes 15 ortakëve (secili ~6.67%)
- Kapitali mund të rritet dhe përbëhet nga para dhe pasuri të tjera

Rregullat e pronësisë

- Transferimi i kuotave bëhet me procedura të përcaktuara dhe me të drejtë parablerjeje për ortakët ekzistues
- Nuk lejohen anëtarë të rinj gjatë fazës së konkursit
- Pas konkursit, mund të shtohen ortakë me miratim

Drejtimi i shoqërisë

- Organ kryesor: Asambleja e Përgjithshme e ortakëve
- Vendos për çështje kryesore si: buxheti, administratori, kapitali, politikat
- Administratori: Ardi Kapllani
 - Përgjegjës për menaxhimin, përfaqësimin dhe aktivitetin e përditshëm

Funksionimi

- Vendimet merren me votë në asamble
- Shoqëria vepron me transparencë dhe përgjegjësi
- Mund të bashkëpunojë me institucione dhe organizata

Financat

- Viti financiar: 1 Janar – 31 Dhjetor
- Fitimet ndahen ose riinvestohen sipas vendimit të asamblesë

Të drejtat dhe detyrimet

Shoqëria ka të drejtë të:

- Kryejë aktivitet ekonomik dhe të investojë
- Punësojë staf dhe bashkëpunëtorë

Ka detyrime të:

- Respektojë ligjin dhe detyrimet fiskale
- Sigurojë punonjësit dhe aktivitetin

Mbyllja e shoqërisë

Shoqëria mund të shpërbëhet:

- Me vendim të asamblesë
- Në rast falimentimi
- Me vendim gjykate ose mungesë aktiviteti



FALEMINDERIT!